

Në bazë të Nenit 26 të Ligjit për sportin e Kosovës dhe Nenit 16 të Statutit të Federatës të basketbollit të Kosovës, Kuvendi i Federatës të basketbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 27.09. 2011, aprovon:

S T A T U T I N E F E D E R A T Ě S S Ě B A S K E T B O L L I T T Ě K O S O V Ě S

I. D I P O Z I T A T E P Ě R G J I T H S H M E

Neni 1.

Federata e basketbollit e Kosovës është asociacion vullnetar i pavarur i klubeve dhe shoqatave të themeluara nga qytetarët, me qëllim të interesave të veçanta dhe përbeshkëta në lëminë e sportit të basketbollit.

Federata e basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Federata) është institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë për meshkuj dhe femra, e cila për veprimtari themelore e ka sportin e basketbollit, e organizuar në pajtushmëri me dispozitat e Ligjit për sportin e Kosovës.

Neni 2.

*Emri i Federatës është: **FEDERATA E BASKETBOLLIT E KOSOVËS.***

*Shkurtesa është: **FBK.***

Selia e Federatës është në Prishtinë.

Federata vepron në territorinë e Kosovës.

Neni 3.

Federata është subjekt juridik dhe vepron në pajtim me Statutin e FIBA-s, Ligjin për sportin e Kosovës dhe Ligjin mbi organizatat jofitimpruese.

Federata përgjigjet për obligimet e krijuara me të gjitha mjetet e saja.

Federata e ka xhirollogarinë e vet.

Neni 4.

Federata, si organizatë jofitimpruese është e regjistruar në organin përgjegjës dhe e licensuar në Ministrinë për rini dhe sport të Kosovës (Departamenti për sport).

Neni 5.

Federata e ka logon, vulen dhe flamurin e vet.

Logoja është e përbër prej topit, tabelës dhe unazës së koshit.

Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe mund të përdoret vetëm me lejen e Bordit të Federatës.

Federata e ka vulën, katrore dhe të rrumbullakët.

Neni 6.

Federata është anëtare e Asociacionit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: AOK).

Federata synon të jetë anëtare e FIBA-së.

Federata punon në bazë të akteve normative të veta, të cilat janë të harmonizuara me ato të Ligjit për sportin e Kosovës, FIBA-s dhe AOK-ut.

Federata mund të anëtarësohet edhe në asociacione të tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare.

Federata është organizatë jashtëpartiake dhe veprimtaria e saj nuk e ka për qëllim çfarëdo aktiviteti politik si dhe nuk mund të anëtarësohet në asnjë organizatë ose parti politike.

Federata nuk lejon çfarëdo mënyre të diskriminimit.

Neni 7.

Federatën e përfaqësojnë Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 8.

Konstituimi i Federatës është i bazuar në parimet e shprehjes së vullnetit të lirë, interesave të përbeshkëta, të drejtave të barabarta dhe në këtë bazë rregullohen marrëdhënjet reciproke, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësia e subjekteve konstituive të Federatës.

Me konstituimin në Federatë, klubet dhe shoqatat pranojnë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësinë, të parashikuara me këtë Statut.

Neni 9.

Federata e njofton opinionin publik me punën e saj nepërmjet: Informatorëve, mjeteve të informimit si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave për media.

Anëtarët e vet i njofton nepërmjet:

-Procesverbaleve dhe publikimeve të tjera, dhe -Mjeteve të informimit.

II. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

Neni 10.

Qëllimet e Federatës janë:

- Masovizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i basketbollit në Kosovë.*
- Sigurimi dhe realizimi i të gjitha kushteve për veprimtarinë e selekcioneve të Federatës.*
- Organizimi dhe avansimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve të basketbollit.*
- Ndihma organizatave të tjera në promovimin e basketbollit në të gjitha fushëveprimet e sportit të basketbollit, në përputhje me aktet normative.*
- Përcaktimi i sistemit të garave për të gjitha kategoria të nivelit të Federatës.*

- Pjesëmarrja në manifestime dhe gara ndërkombëtare.
- Mbështetja e zhvillimit të basketbollit në vise të pazhvilluara të Kosovës.
- Organizimi i të gjitha garave në nivel të Kosovës, si janë: Ligat, KUP-a dhe turnet.
- Organizimi i aktiviteteve profesionale vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i kampeve, seminareve, publikimeve profesionale etj.
- Sigurimi i bazës materiale për sportin e basketbollit nepërmjet marketingut, aktiviteteve ekonomike me qëllim të përmbushjës të kërkesave për veprimtarinë e Federatës.
- Përcaktimi i parimeve themelore mbi definimin e statusit të të gjithë subjekteve në kuadër të Federatës.
- Pjesëmarrja në punën e AOK-ut dhe asociacioneve të tjera sportive.
- Veprimi kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e AOK-ut dhe FIBA-s.
- Pjesëmarrja në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me sportin e basketbollit.

III. ANËTARËT E FEDERATËS

Neni 11.

Anëtarët e Federatës janë: Klubet e basketbollit (publike dhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e gjyqtarëve(organizata profesionale të Federatës), dhe të gjitha klubet dhe shoqatat e tjera të cilat pranohen dhe licencohen në Federatë.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në Federatë janë:

- Deklarata me shkrim e klubit ose shoqatës për aplikim dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera normative të Federatës.
- Çertifikata për regjistrimin e klubit ose shoqatës
- Nënshkrimet e themeluesve dhe numrat e kartelave të identifikimit -Statutin - Rregulloren mbi punën e Kuvendit -Rregulloren mbi punën e Këshilli Mbikqyrës - Emrat e personave të autorizuar për përfaqësim -Numri i xhirlogarisë
- Marrëveshja për zgjidhjen e kontesteve Bordi i Federatës i pranon anëtarët e ri ndërsa Kuvendi e verifikon anëtarësimin e tyre nëFederatë.

Neni 12.

Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguajë anëtarësin; vjetore, të cilën e cakton Kuvendi i Federatës.

Anëtari mund të dal nga Federata atëherë kur i kryen të gjitha obligimet financiare ndaj Federatës dhe anëtarëve të saj.

Anëtari mund të përjashtohet nga Federata kur bën shkelje të rendë të Statutit dhe akteve të tjera normative të Federatës.

Vendimin mbi përjashtim nga anëtarësia e bie Kuvendi i Federatës.

Efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjës së vendimit.

IV. ORGANET E FEDERATËS

Neni 13.

*Organet e Federatës janë:
-Kuvendi -Bordi -Kryetari -Këshilli mbikëqyrës*

V. KUVENDI

Neni 14.

Kuvendi është organi më i lartë i Federatës.

Kuvendin e Federatës e përbejnë delegatët e autorizuar të klubeve dhe shoqatave, , dhe atë: nga dy (2) delegatë të klubeve të Superligës për meshkuj dhe nga një(1) delegat i klubeve të Ligës së femrave, ligave të tjera për meshkuj senior, Shoqata e trajnerëve, Shoqata e gjyqtarëve dhe Shoqatat e tjera të basketbollit të pranuar dhe licencuara në Federatë.

Klubi i cili dy vjet rresht nuk garon,e humb te drejten e perfaqësimit në Kuvend.

Në mbledhjen e Kuvendit marrine pjesë anëtarët e Këshillit mbikëqyrës por pa të drejtën e votës.

Në punën e Kuvendit mund të marrin pjesë edhe mysafirët e ftuar por pa të drejtën e votës.

Neni 15.

Vetëm delegatët e autorizuar të klubeve dhe shoqatave kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Federatës.

Numrin e përgjithshëm të delegatëve të autorizuar e cakton Kuvendi me vendim të vaçantë.

Neni 16.

Mandati i delegatit në Kuvend zgjatë katër (4) vjet.

Delegati në Kuvend dhe në organet e Kuvendit për kryerjen e detyrës së delegatit I përgjigjet organizatës (klubit ose shoqatës) e cila e ka deleguar dhe organit në të cilin ai kryen detyrën e delegatit.

Në qoftë se delegati nuk e kryen detyrën e tij me përgjegjësi, mund të revokohet edhe para skadimit të mandatit sipas procedimit të parashikuar. Propozimin mbi revokim mund ta bëjnë klubi ose shoqata e cila e ka deleguar ose organi i Kuvendit ku ai kryen detyrën e delegatit. Delegati revokohet nga klubi ose shoqata dhe në vend të tij delegon delegatin tjetër.

Neni 17.

Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Kuvendi i rregullt mbahet sipas nevojës, por më së paku një(1) here në vjet, të cilin e konvokon Bordi.

Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasin Kryetari, Bordi, 2/3 e anëtarëve të Federatës ose me kërkesën e Këshillit mbikëqyrës.

Ftesa për Kuvend duhet të dërgohet më së largu 14 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 7 ditë para Kuvendit.

Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të vendos vetëm për çështjet për të cilat është konvokuar.

Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta konvokoj Kryetari në afat prej 30 ditëve, prej ditës së kërkesës, në të kundërtën Kuvendin mund ta konvokoj edhe inicuesi.

Neni 18.

Kuvendi mund të bie vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e delegatëve të Kuvendit.

Neni 19.

Kuvendi e zgjedh kryesinë e punës, procesmbajtësin, komisionin verifikues dhe në qoftë se ka nevojë edhe trupa të tjera punuese.

Në mbledhje mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruajnë Kryetari, anëtarët e kryesisë së punës dhe procesmbajtësi.

Kuvendi merr vendime me votat e shumicës të delegatëve të autorizuar prezentë në Kuvend, të cilët kanë të drejtën e votës.

Në qoftë se vendoset për ndryshimet e Statutit, atëherë nevojitet vota e 2/3 e numrit të

delegatëve prezentë në Kuvend.

Votimi në Kuvend është publik, në qoftë se Kuvendi nuk vendos ndryshe.

Kuvendin e udhëheq kryesia e punës, të cilën e përbejnë: Kryetari i Federatës dhe dy (2) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi.

Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e Federatës.

Procedimi dhe mënyra e punës së Kuvendit më përafërsisht rregullohen me Rregullorën e punës së Kuvendit.

Neni 20.

Shpenzimet e pjesëmarrjës në mbledhjen e Kuvendit i bartin vet anëtarët e Kuvendit.

Neni 21.

Kuvendi, si organ më i lartë i Federatës, në fushëveprimtarinë e vet kryen veçanarisht këto punë:

- Aprovon Statutin e Federatës.*
- Aprovon Rregullorën e garave të Federatës.*
- Aprovon Rregullorën mbi kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve.*
- Aprovon Rregullorën disiplinore.*
- Aprovon sistemin e garave për të gjitha kategoritë.*
- Miraton raportet e punës të organeve të veta.*
- Sajon politikën e Federatës.*

-Aprovon programet afatmesme, programin vjetor, planin financiar dhe llogarinë përfundimtare vjetore.

- Verifikon mandatin e delegatëve të autorizuar në Kuvend.

-Pranon anëtarë të ri dhe përjashton anëtarët nga anëtarësia e Federatës.

-Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Bordit.

-Zgjedh dhe shkarkon Këshillin mbikëqyrës.

-Vendos në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike. -Vendos mbi pushimin e punës së Federatës.

-Vendos mbi faljen e dënimeve -Aprovon Rregullorën mbi punën e Kuvendit.

-Shqyrton programet dhe raportet e shoqatave. -Interpreton Statutin e Federatës.

-Kryen edhe punë të tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera të Federatës.

-Kuvendi, me vendim të veçantë mund të bart Bordit ndonjë nga kompetencat e veta.

VI. BORDI

Neni 22.

Bordi udhëheq punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit.. Mbledhjet e Bordit i konvokon Kryetari e në mungesë të tij, njëri nga dy (2) nënkryetarët . Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të konvokohet në qoftë se për një gjë të tillë deklarohen shumica e anëtarëve të Bordit.

Neni 23.

Bordi numron 11 anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari, dy (2) nënkryetarë dhe tetë (8) anëtarë.

Bordin e zgjedh Kuvendi nga rradha e delegateëve të autorizuar të Kuvendit, dhe atë: Kryetarin, dy (2) nënkryetarë dhe gjashtë (6) anëtarë të tjerë, ndërsa Kryetari i zgjedh dy (2) anëtarë nga radha e delegatëve të autorizuar të Kuvendit.

Dy kandidatë(njërin nga radha e minoriteteve) për Nënkyetar propozon Kryetari dhe

dy të tjerë((njërin nga radha e minoriteteve) delegatët e Kuvendit.

Të zgjedhur konsiderohen ata që fitojnë shumicën e votave(njëri nga komuniteti shumicë dhe njëri nga minoritarët).

6 kandidatë(së paku një nga radha e gjinisë femrore) për anëtarë të Bordit i propozon Kryetari,ndërsa kandidatët tjerë (së paku një nga radha e gjinisë femrore) për anëtarë të Bordit i propozojnë delegatët e Kuvendit. Anëtarë të Bordit zgjidhen 6 kandidatët që fitojnë më së shumti vota. Në rast se në mesin e 6 kandidatëve me më shumë vota nuk është asnjë femër,atëherë vendin e anëtarit të gjashtë e merr kandidatja femër që ka fituar më shumë vota.

Në Bord duhet të jenë të përfaqësuar edhe minoritetet dhe femrat, në përputhje me Ligjin për sport të Kosovës. Kryetari i Federatës është edhe Kryetar i Kuvendit dhe i Bordit.

Neni 24.

Bordi zgjedhet me mandat katër (4) vjeçar, sa është edhe mandati i Kuvendit, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.

Bordi për punën e vet i përgjigjet Kuvendit.

Anëtari i Bordit ose i tërë Bordi mund të shkarkohen nga Kuvendi edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e tjera normative të Federatës.

-Anëtari i Bordit të Federatës së Basketbollit,i cili në tri(3)mbledhje të Bordit mungon pa arsye,konsiderohet si anëtar në dorëheqje dhe Bordi merrë vendime duke mos marrë në konsideratë votën e tij.Anëtari në dorëheqje,shkarkohet nga Kuvendi i ardhshëm dhe zavendësohet me anëtarë të ri.

Në rastet kur shkarkohet Bordi në tërësi, Kuvendi mund të zgjedh një trup punues (Këshill ose Komision) nga rradha e delegateëve të autorizuar të Kuvendit i cili do t'i kryejë punët e Bordit deri në mbledhjen e Kuvendit zgjedhor. Ky afat mund të jetë më së shumti deri 90 ditë nga dita e zgjedhjes të këtij trupi punues.

Mbi numrin e anëtarëve të trupit punues vendos Kuvendi.

Neni 25.

Bordi në fushëveprimtarinë e vet kryen veçanarisht këto punë:

- Bie vendimin mbi konvokimin dhe propozimin e rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit.*
- Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve të tjera të Kuvendit.*
- bie Rregulloren mbi licencimin e klubeve dhe shoqatave - Ekzekuton vendimet dhe konkluzionet e Kuvendit.*
- Bie Rregullorën mbi punën e Bordit.*
- Përpilon planin e punës dhe planin financiar vjetor të Federatës.*
- Ekzekuton politikën e përgjithshme të Federatës.*
- Emron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm.*
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e trupave punuese të Bordit.*
- Vendos mbi blerjen dhe shitjen e pasurisë së Federatës.*
- Aprovon listën e zyrtarëve (gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve) të ndeshjeve.*
- Bie rregulloret e brendëshme të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.*
- Shqyrton dhe aprovon plan-programin e Këshillit profesional.*
- Bie Rregullorën mbi punën e reprezentacioneve të Federatës.*
- Emëron dhe shkarkon Komisararin e garave.*
- Miraton kalendarin dhe Propozicionet e garave.*
- Bart të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës.*
- Cakton lartësinë e taksës për zyrtarët e ndeshjeve.*
- Cakton lartësinë e kotizimit për klubet dhe lartësinë e shërbimeve të cilat i kryen Federata për klubet.*
- Bie Rregullorën mbi sistematizimin e vendeve të punës.*
- Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përherëshme dhe përkohëshme dhe lartësinë e pagave të tyre.*
- Bie Rregulloren për punën e Komisionit arbiter,si organ i shkallës së dytë*
- Vendos edhe për çeshtjet e tjera për të cilat e autorizon Kuvendi ose nuk janë të parashikuara me këtë Statut.*

Neni 26.

Bordi mund të formojë trupa punuese (Këshilla dhe Komisione) të përherëshme dhe përkohëshme, vendos për kompetenca dhe emëron anëtarët e tyre.

Këshillat dhe Komisionet për punën e tyre i përgjigjen Bordit.

Mënyra e punës dhe procedimi i vendimmarrjës në trupat punuese më afërsisht rregullohen me Rregullorën mbi punën e Bordit.

Mandat i anëtarëve të trupave punuese zgjatë katër (4) vjet me mundësi të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.

Bordi mund të shkarkojë trupat punuese ose anëtarin e tij edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se detyrat e besuara nuk i kanë kryer me përgjegjësi dhe në kundërshtim me aktet normative të Federatës.

Trupat e përherëshme të punës (Këshillat dhe Komisione) janë:

-Këshilli profesional. -Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve.

-Komisioni disiplinor. -Komisioni - Komisarari i garave.

-Komisioni Arbitrar Mandati i Komisionit-Komisarit të garave zgjat një (1) edicion garues.

VII. KRYETARI

Neni 27.

Kryetarin e zgjedh Kuvendi me mandat katër (4) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.

Kandidatët për Kryetar mund të propozojnë: Bordi i Federatës (një kandidat)dhe më së paku shtatë (7) anëtar të Federatës mund të propozojnë një kandidat.

Kryetar zgjedhet ai kandidat i cili në rrethin e parë të votimit merr më së paku 2/3 e votave të delegateëve të pranishëm në Kuvend. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin në rrethin e dytë të votimit delegateët e Kuvendit votojnë për dy (2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave. Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar zgjedhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.

Neni 28.

Kryetari në fushëveprimin e vet kryen veçanarisht këto punë:

- Përfaqëson Federatën në Kosovë dhe jashtë.

-Udhëheq mbledhjet e Kuvendit.

-Konvokon dhe udhëheq me punën e Bordit. -Kujdeset për realizimin e programeve, planeve dhe konkluzioneve të Kuvendit dhe Bordit.

-Kujdeset dhe është përgjegjës për punën e ligjshmërisë në Federatë.

-Është urdhërdhënës dhe përgjegjës për realizimin e planit financiar.

-Nënshkruan vendimet dhe aktet të cilat i bie Kuvendi dhe Bordi.

-Kujdeset për përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Kuvendit dhe Bordit.

-Zbaton dhe udhëheq politikën e Federatës

-Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga ky Statut dhe vendimet e Kuvendit.

Neni 29.

Kryetari për punën e tij i përgjigjet Kuvendit.

Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e tjera normative të Federatës.

Pas shkarkimit të Kryetarit, Kuvendi zgjedh Kryetarin e ri sipas procedurës së parashikuar me Nenin 27 të këtij Statuti.

VIII. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 30.

Sekretarin e Përgjithshëm e emëron Bordi me mandate katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.

Kriteret dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për emrimin e Sekretarit të Përgjithshëm parashikohen me Rregullorën mbi punën e Bordit.

Neni 31.

Sekretari i Përgjithshëm në fushëveprimtarinë e vet i kryen veçanarisht këto punë:

-Përfaqëson Federatën, sipas autorizimeve të Bordit.

-Është urdhërdhenës për realizimin e planit financiar.

-Udhëheq dhe është përgjegjës për punën e zyrës së Federatës.

-Kujdeset dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës në Federatë. -Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Bordit dhe trupave punuese.

-Së beshku me Kryetarin përgatit materialet për mbledhjen e Kuvendit dhe Bordit.

-Kryen punët me të cilat e ngarkon Bordi.

-I propozon Bordit formimin e trupave punuese.

-Realizon bashkëpunimin me FIBA, Federatat e basketbollit dhe organizatat e tjera sportive jashtë Kosovës.

--Realizon bashkëpunimin me AOK-un dhe Departamen-tin e sporteve dhe organizatat e tjera sportive të Kosovës.

- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve dhe trupave punuese të Bordit në cilësinë e këshilldhënsit.

-Mbanë kontakte me mjetet e informimit.

-Harton Rregullorën e sistematizimit të vendeve të punës në Federatë.

-I propozon Bordit profilin e bashkëpunëtorëve administrativo-profesional.

-Interpreton aktet e brëndëshme normative të Federatës.

-Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga aktet normative të Federatës.

Neni 32.

Sekretari i Përgjithshëm me Federatën themelon marrëdhënie të punës me kontratë në afatin e caktuar të mandatit katër (4) vjeçar, në bazë të Ligjit mbi marrëdhënie të punës.

Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij, në qoftë se nuk i kryen obligimet me përgjegjësi të cilat dalin nga aktet normative të

Federatës ose shkeljës dhe sjelljës së rëndë të dispozitave të Ligjit mbi marrëdhënie të punës.

Sekretarin e Përgjithshëm, në rast të mungesës së tij, e zëvendëson personi të cilin e cakton Bordi.

IX. KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 33.

Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej tre (3) anëtarëve.

Këshillin mbikëqyrës e zgjedh Kuvendi me mandat katër (4) vjeçar. Në mandatin vijues Këshilli mbikëqyrës zgjedhet nga radha e anëtarëve të Federatës (klubet dhe shoqatat) të cilat nuk kanë qenë të zgjedhur në mandatin e mëparshëm.

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë nga radha e delagatëve të autorizuar të Kuvendit. Anëtari i Këshillit mbikëqyrës nuk mund të jetë anëtar i organeve dhe trupave punuese të Federatës. Bordi dhe të gjitha trupat punuese të tija janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen e punës së tyre.

Këshilli mbikëqyrës e përcjell ligjshmërinë e punës së Bordit dhe trupave punuese mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyr afarizmin financiar të Federatës.

Këshillë mbikëqyrës i raporton për punën e vet Kuvendit të Federatës Mënyra e punës dhe procedimi i vendimmarrjes në Këshillin mbikëqyrës më përafërsisht përcaktohen me Rregullorën mbi punën e Këshillit mbikëqyrës.

X. KËSHILLI PROFESIONAL

Neni 34.

Veprimtaria themelore e Këshillit Profesional, si trup punues profesional i Bordit, është avansimi i punës profesionale në Federatë veçanarisht me selekcionet e Federatës.

Këshilli profesional inicon dhe nxit aktivitete për zgjidhjen e çështjeve të cilat janë në dobi të zhvillimit dhe ngritjes së cilësisë së basketbollit nepërmjet bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me klubet dhe shoqatat profesionale të Federatës.

Këshilli profesional numron 7-9 anëtarë, të cilët i emëron Bordi. Anëtarër e Këshillit profesional mund të jenë ish basketbollistët e shquar, trajner, mjek, gazetar sportiv etj.

Mandati i Këshillit profesional zgjat katër (4) vjet, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.

Këshilli profesional për punën e vet i përgjigjet Bordit.

Në fushëveprimtarinë e vet Këshilli profesional kryen veçanarisht këto punë:

- Përcjell zhvillimin e basketbollit brënda dhe jashtë Kosovës.

- Përcjell dhe mbikëqyr realizimin e plan-programeve profesionale të aprovuara nga Bordi

- Kujdeset për zhvillimin profesional dhe popullarizimin e basketbollit në Kosovë.

- Bashkëpunon me organizatat profesionale dhe shkencore me qëllim të avansimit të punës profesionale.

- I propozon Bordit emërimin dhe shkarkimin e trajnerëve të reprezentacioneve të Federatës.

*-Kujdeset për përparimin profesional të trajnerëve.
-Harton dhe i propozon Bordit aprovimin e plan-programeve për zhvillimin e basketbollit për kategoritë e reja.
-Propozon sistemin e garave për të gjitha kategoritë.
- Kryen edhe punë të tjera me të cilat e ngarkon Bordi.
Anëtarit ose Këshilli profesional mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se nuk i kryen detyrat me përgjegjësi dhe në kundërshtim me aktet normative të Federatës Emërimi i anëtarit(ve) të ri bëhet sipas procedimit të parashikuar në Nenin 26 ,alinea 5 e këtij Statuti.*

Neni 35.

Shoqata e trajnerëve dhe Shoqata e gjyqtarëve, si organizata profesionale të Federatës, zbatojnë politikën e veprimtarisë së tyre në pajtueshmëri me aktet e tyre normative dhe Statutit dhe akteve të tjera normative të Federatës. Ato janë të pavarura në kryerjen e veprimtarisë së tyre nëpërmjet organeve drejtuese të zgjedhura në përputhje me aktet e tyre normative.

Shoqata e trajnerëve dhe Shoqata e gjyqtarëve nuk mund të kenë të drejtat dhe statusin e Federatës së degës sportive.

Shoqata e trajnerëve dhe Shoqata e gjyqtarëve, si organizata profesionale të Federatës, janë të obliguara t'i raportojnë me shkrim Bordit të Federatës në lidhje me aktivitetet e tyre.

Statuti i Shoqatës së trajnerëve dhe Shoqatës së gjyqtarëve duhet të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e këtij Statuti.

Plan-programet e punës me kërkesë për realizimin e tyre I parashtrojnë Bordit të Federatës për shqyrtim dhe miratim.

Bordi i Federatës, në rastet e jashtëzakonshme mund të ndërmerr masa më qëllim të zgjedhjes se çeshjteve të cilat pamundësojnë punën e tyre normale dhe të sukseshme.

Neni 36.

Ligat e basketbollit mund të formojnë Drejtoratet e tyre vetëm në marrëveshje me Federatën-Bordin dhe miratimin e Kuvendit të FBK-së.

X. FINANSIMI I FEDERATËS

Neni 37.

Federata finansohet nga:

-Anëtarësia e klubeve dhe shoqatave. -Kotizimi i klubeve.

-Donacionet e personave fizik dhe juridik. -Marketingu.

-Të hyrat nga organizimi i garave.

-Dotacionet nga Drejtorati për sport për aktivitete të caktuara

-Burimet e tjera të lejuara në bazë të Ligjit.

-Nga TV transmetimet.

Realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve kryhet sipas planit financiar të cilin e bie Kuvendi i Federatës në fillim të vitit.

Neni 38.

Veprimtarinë materijalo-finansiare të Federatës e udhëheq referenti financiar. Referentin financiar e emëron Bordi, me të cilin mund të lidh kontratë mbi kryerjen e detyrave me afat të caktuar, në përputhje me Ligjin mbi marrëdhënien e punës.

XI. GARAT

Neni 39.

Garat zyrtare në Kosovë mund të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga Bordi i Federatës.

Garat zhvillohen në bazë të Rregullave zyrtare të FIBA-s dhe rregullave dhe akteve të Federatës. Në udhëheqjen e garave, organi përkatës i garave duhet t'i respektojë të gjitha vendimet e FIBA-s. Kalendarin dhe Propozicionet e garave kampionale dhe të KUP-ës i miraton Bordi.

XII. REPRESENTACIONET

Neni 40.

Federata është e obliguar të kujdeset për punën e reprezentacioneve dhe brënda mundësive financiare duhet t'u mundësojë kushte sa më të mira për punë.

Paraqitja për reprezentacionin e Kosovës është obligim dhe nder për çdo anëtar të saj.

XIII. SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

Neni 41.

Federata mund të themelojë marrëdhënie të punës në afat të caktuar me punëtorët të cilët do të punojnë dhe kryejnë shërbime profesionale, administrative dhe financiare për Federatën.

Për punësimin e punëtorëve dhe lartësinë e pagave vendos Bordi me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 42.

Punëtorët e Shërbimit administrativo-profesional të drejtat dhe obligimet e tyre nga marrëdhënia e punës i realizojnë në bazë të Ligjit mbi marrëdhënie të punës të Kosovës.

Neni 43.

Mjetet për punën e Shërbimit administrativo-profesional i siguron Federata, të cilat përcaktohen me Planin financiar.

XIV. RREGULLORET E BRËNDSHME

Neni 44.

Rregulloret e brëndshme të cilat kanë të bejnë me garat zyrtare të Federatës si dhe Propozicionet e garave nuk mund të pësojnë ndryshime gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhë e sipër.

Neni 45.

Në procedurat administrative të cilat zhvillohen pranë organeve të Federatës mund të përdoren mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike Për çeshtjet administrative të cilat nuk janë rregulluar me këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Kodit mbi procedurat administrative. Deri në miratimin e Kodit të sipërpërmendur do të aplikohen dispozitat e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrativ.

XV. TË PUSHUARIT E PUNËS SË FEDERATËS

Neni 46.

Federata pushon punën e saj kur për këtë deklarohen 2/3 e anëtarëve të anëtarësuar në Federatë, ose sipas Ligjit.

Në qoftë se pushon puna e Federatës, atëherë e tërë pasuria e saj (aktiva dhe pasiva) i kalon organizatës e cila i merrë të drejtat dhe detyrat e Federatës.

XVI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 47.

Organet e Federatës janë të obliguara t'i harmoniozojnë aktet e tyre të përgjithshme normative me këtë Statut në afatin prej më së largu 90 ditë nga dita e aprovimit të këtij Statuti.

Neni 48.

Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Federatës. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i Federatës i aprovuar me 16.shtator 2006.

Anëtarët e Federatës duhet të harmonizojnë Statutet e tyre me këtë Statut në afat prej 60 ditësh.

Neni 49.

Interpretimin zyrtar të këtij Statuti e bënë Kuvendi.

KUVENDI I FBK-së
Kryetari,
Fatmir Gashi